REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**
**AKADEMIA E SIGURISË**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 32
Dt. 13.04.23.

**VENDIM**

Nr. 21, datë 13.04.2023

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË AKADEMISË SË SIGURISË PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTIT PËR DHËNIEN ME QIRA TË AMBJENTIT BAR-KAFE BRENDA AS-SË.**

Në zbatim të germës "gj", pika 1, të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqiperisë", Bordi i Administrimiti Akademisë së Sigurisë në mbledhjen e datës 13.04.2023, pasi shqyrtoi kërkesën nr. 785 datë 29.03.2023 e paraqitur nga Akademia e Sigurisë, "Kërkesë mbi përzgjedhjen e subjektit për dhënien me qira të ambjentit brenda Akademisë së Sigurisë për bar-kafe";

**KONSTATOI SE:**

Akademia e Sigurisë me shkresën nr.785 datë 29.03.2023 ka referuar pranë Bordit të Administrimit kërkesën për përzgjedhjen e subjektit për dhënien me qëra të një ambjeti brenda Akademisë së Sigurisë për "bar-kafe", së bashku me dokumentacionin e dorëzuar nga subjektet përkatëse.
Lidhur me kërsesën e mësipërme, Bordi i Administrimit me vendimin nr.18 datë 29.12.2022, ka shprehur miratimin e dhënies me qera të këtij objekti.

Bordi i Administrimit konstaton se referuar Vendimit nr.54 datë 05.02.2014 të Këshilit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterave, të procedurës e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, është në kompetencat e institucionit, konkretisht Akademisë së Sigurisë për kryerjen e procedurave të mëtejshme për përzgjedhjen e subjektit për dhënien me qera të këtij ambjenti.
Sa sipër Bordi i Administrimit të Akademisë së Sigurisë:

**VENDOSI :**

1. Mospranimin e kërkesës e Akademisë së Sigurisë për përzgjedhjen e subjektit për dhënien me qira të ambjentit brenda Akademisë së Sigurisë për bar-kafe.

2. Sekretaria të protokollojë këtë vendim, administrojë dhe një kopje të dërgojë Akademisë së Sigurisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT I AKADEMISË SË SIGURISË**

KRYETARI

Sokol BIZHGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT AKADEMIA E SIGURISË TIRANË